



PRANUAR ME: 27/02/2023
ACCEPTED ON:
PRIMLJENO:
Nr. M. R. 02/112



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/

Datë: 27.02.2023

PROCESVERBAL

i mbledhjes së -I- (parë) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës

RENDI I DITËS

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
- 2.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Kuvendit për vitin 2022.
- 3.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport.
- 4.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komitetit për Barazi Gjinore.
- 5.Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të varrimit për vitin 2022.
- 6.Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- 7.Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për orar të punës së subjekteve afariste.
- 8.Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Shërbime Publike.
- 9.Formimi i Komisionit për emërtimin e rrugëve.
- 10.Formimi i Komisionit për zgjedhjen e Bashkësive Lokale.
- 11.Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 30.01.2022 dhe filloi në ora: 10:30. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 25 asambleistë, nënkryetari, drejtorë komunal, dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës z.Argjend Thaçi.

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë, mirë se keni ardhur në seancën e parë të rregullt të Kuvendit Komunal për vitin 2023. Meqenëse është seanca e parë për këtë vit, uroj që të shkoj ky vit i mbarë për ju dhe qytetarët e Komunës së Malishevës.

Prezent janë 25 anëtarë të kuvendit që do të thotë kemi korum dhe mundemi të vazhdojmë me punimet e seancës. A keni ndonjë qështje për të ngritur e cila është në interes të qytetarëve të Komunës së Malishevës?

Fjalën e ka Nebih Bibaj.

Nebih Bibaj: Përshëndetje për të gjithë!

Pasi që jemi jashtë rendit të ditës dëshiroj t'i ngris disa qështje të cilat janë në interes të qytetarëve. Para se të filloj me këto e kam një shqetësim. Kryesues te vonesa e mbledhjeve që po na bëhet sot e mirëkuptojmë pasi që ka qenë një përkujtim, është mirë që kjo qështje të rregullohet për herave të tjera.

Qështja tjetër që dua ta ngris është në mbledhjen e kaluar të muajit dhjetor më shumë ke qenë në anën e ekzekutivit se të kuvendit. Kryesues t'i je anëtar i kuvendit, je kryesues i joni, je zgjedhur me votat e kuvendit, t'i e përfaqëson Kuvendin ndërsa ekzekutivi e përfaqëson Kryetarin. Ato seanca kanë qenë të jashtëligjshme sikur që ta ka kthyer vendimin Ministria, është dashur të i thirrësh të gjithë shefat e grupeve që të caktohet seanca e radhës dhe jo të veprohet në mënyrë të një anëshme. Është mirë që si Kryesues të bashkëpunosh me shefat e grupeve, unë në atë seancë nuk kam qenë prezent, listen e nënshkrimeve nuk mundesh t'i me e marrë dhe me rezultu që nuk po dëshirojnë të nënshkruajnë anëtarët e Kuvendit. Nëse t'i e ke mbyll seancën për një pikë ose kanë dalë jashtë për një pikë të rendit të ditës dhe kemi pasur vullnet për vazhdimin e pikës tjetër t'i nuk mundesh në mënyr arbitrale me e mbyll seancën, sepse duhet të kthehemi në seancë të kemi një votim të paktën për mbylljen e seancës apo shtyerjen e seancës.

Qështja tjetër në interes të qytetarëve pasi që qenka Drejtori i Urbanizimit këtu, mënyra se si kanë fillu punimet në rrugën "Ibrahim Mazreku", kur do të filloj faza e dytë sepse po shkakton probleme të mëdha dhe është mirë që të fillojnë sa më shpejtë punimet.

Nënkryetar është mirë me definu pasi që e kam parë një informim publik të rritjes së tatimit në pronë nga ueb-faqja e Komunës, është mirë të bëni një sqarim publik rreth rritjes së tarifës, sepse ka qytetarë që na përcjellin dhe ju e keni përgjegjësin institucionale që të bëni një deklaram publik dhe ta sqaroni se përse ka adhur deri te rritja e tatimit në pronë. A është si pasojë e neglizhencës së Komunës apo është një rritje e qeverisë në nivel qendror për arsye se ne nuk i kemi përfunduar detyrat tona me kohë?

Argjend Thaçi: Urdhëro Halil Morina!

Halil Morina: Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë!

Sa i përket mbledhjes së kaluar dhe problematikave që kanë ndodhur në mbledhjen e kaluar, kur

një mbledhje ndërprehet për arsye të mungesës së korumit, ajo mbledhje nuk është mbyllur por ajo mbledhje është ndërpre dhe kur do që bëhet korumi ajo mbledhje vazhdohet aty ku ka mbetur. Pika për të cilën anëtarët e Kuvendit kanë dalë jashtë duhet me i dhënë epilog, nuk mundemi me ja fillu pikës tjetër dhe atë pikë me e lënë ashtu si është. I vetmi gabim që është bërë në këtë problematik është për arsye se nuk i ka shkuar email-i, dhe përfaqësuesi i kuvendit nuk i ka informuar me kohë asambleistët për seancë. Një seancë mundet me u thirr 10 herë deri të bëhet korumi nuk ka asnjë shkelje ligjore, mirëpo anëtarët e kuvendit duhet me i njoftu, ka qenë një qështje teknike dhe dikush tjetër e ka përdorur këtë dhe e ka anuluar atë mbledhje. Çka ke anuluar në atë mbledhje vetëm 3 ose 4 pika ndihmë të qytetarëve të cilët kanë qenë të sëmur, këto pika prapë kanë me u trajtu sepse janë kërkesa të domosdoshme. Kryesues, konfirmoe mirë që ju ke dërgu të gjithë antarëve të kuvendit ftesën qoftë për seancë të rregullt, qoftë të jashtëzakonshme.

Argjend Thaçi: Anëtarët e opozitës kanë bërë deklaram që nuk marrin pjesë në seancë, prap ju kam dërguar email të gjithëve për vazhdimin e seancës dhe është konfirmuar që i është shkuar emaili i datës 29.12.2022, prapë ju kam dërguar email me datën 30.12.2022 arsyetimi është që me datën 30 nuk i është dërguar emaili. Kjo ka qenë një tendenc e arsyes për anulim të seancës dhe nuk besoj që i ka bërë nder askujt ky anulim i seancës duke pasur parasysh që kanë qenë pika shumë të rëndësishme sidomos këto që kanë pasur të bëjnë me ndihma financiare posaqërisht atyre që janë të prekur me cancer.

Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Përshëndetje për të gjithë!

Në mënyrë tërthorazi Halili aludoj që ne e paskemi anulë atë seancë, duke përdorur linja të tjera të komunikimit, në seancën e kaluar e kam përdorur një rrjet më demokratik të mundshëm me një pikë të rendit të ditës ku paraprakisht si shef i grupit i VV kam kërkuar me u largu nga rendi i ditës. E kam paralajmëruar se nëse nuk largohet nga rendi i ditës ne si grup i VV nuk marrim pjesë në votim për atë pikë dhe e lirojmë sallën. Dhe kolegët e tjerë opozitar e kanë mbështet qëndrimin tonë dhe e kanë lëshuar seancën, jemi kthyer në seancë pastaj ju e keni lëshuar seancën, rendi e ka dashtë me qëndru pa marrë parasysh a ka korum apo nuk ka dhe nëse vetëm një anëtarë qëndron kryesuesi duhet të dalë i fundit nga seanca. Seanca është anuluar sepse ka pasur shkelje të ligjit, unë kam bërë dhe herave të tjera ankes për pikat e rendit të ditës por mu kanë refuzuar si ankesa.

Unë kam disa qështje të tjera të cilat janë në interes të qytetarëve. Unë kam biseduar me disa kolegë të mi të cilët punojnë në disa shkolla. Më kanë treguar që nuk kanë material të mjaftueshëm shkollor, sa herë kanë teste të nxënësve mësimdhënësit e shkollave detyrohen me i ble vet materialin për printer, dhe fletat e bardha sepse nuk janë në shkollë. Nuk i kam vizituar këto shkolla po e kam marrë si informacion jo nga një person por shumë prej tyre. Ne kemi ndarë buxhet për mirëmbajtje të shkollave.

E kam një pyetje për Drejtoreshën e Arsimit, e dimë që ka qenë një konkurs për Drejtor të shkollave, është formuar komisioni nga kuvendi dhe anëtarëve nga zyra e Kryetarit nuk e di ku

ka përfundu, a janë zgjedh drejtorët është mirë të dimë këtë informacion.

Një pyetje tjetër për Drejtoreshën e Arsimit, qerdhet në Kijev dhe Malishevë kur pritët me u funksionalizimi këto institucione, sepse qytetarët presin me i dërgu fëmijet e tyre, përfunduan 5 muaj dhe është etike me u përfundu kjo punë. Sa kam informacione Ministria e Arsimit e ka lejuar rritjen e numrit të stafit për funksionalizimin e kësaj qerdhe.

Një pyetje tjetër kam për Drejtorin e Urbanizmit çka është duke ndodhur me ndërtimet në Malishevë, ka ndërtime banesore të QKMF-ja, sipas ligjit duhet me qenë 40% ndërtim dhe 60% gjelbërim këto kritere nuk janë duke u zbatu. Nuk e di a inspekton dhe qysh lejohen këto ndërtime kështu?

Argjend Thaçi: Urdhëro, Mirëllinda Gashi!

Mirëllinda Gashi: Ne mbledhjen nuk e kemi lëshuar për mos t'i vazhduar pikat e tjera, ky ka qenë një pazar i juaji që ka filluar në zyrën e kryesuesit paraprakisht, që ju keni kërkuar që shefat e grupeve me marrë pjesë me bërë një kombinim se si dëshirojmë me shku me këtë pikë të rendit të ditës. Ne nuk kemi marrë pjesë në atë takim jeni shkuar vetëm. Ne debatin e kemi përfunduar këtu komplet pastaj kemi lëshuar mbledhjen vetëm për votim, por që të vazhdojmë me pika të tjera të rendit të ditës. Ne nuk e kemi lëshuar mbledhjen kemi qenë në sallë e kemi thirrur Kryesuesin në telefon, kemi ndenjur dhe 20min në sallë i kemi thirrë ejani që ta vazhdojmë seancën sepse kemi pikat e tjera, kemi kërkesat duhet ta vazhdojmë dhe ju nuk jeni kthyer. Kjo ka qenë ajo çka ka ndodhur atë ditë, mirëpo mirë që janë institucionet përkatëse dhe është kthyer mbledhja në pikën zero.

Argjend Thaçi: Të gjitha pikat një nga një kanë kaluar, por nuk duhet me shfrytëzu rastin që një asambleist ose anëtar i kuvendit i mazhorancës për arsye familjare apo të ndryshme nuk mund të vjen në kuvend me shfrytëzu një korum të tillë.

Urdhëro, Nebih Bibaj!

Nebih Bibaj: Në fillim e ceka Kryesues që t'i je i Kuvendit. Për shkak të presionit të madh që keni sepse jeni në fazën e fundit të kualicionit keni arritur t'i bëni këto gjëra. Prapë po ta përsëris nuk ka rëndësi se kush i ka numrat më shumë në Kuvend, mbaje poziten e Kryesuesit kjo ka rëndësi për ty. Nuk kanë qenë kërkesat e qytetarëve që ne kemi dalur jashtë, ka qenë një kërkesë puro që ne dyshojmë që mundet me pas diçka tjetër kjo është arsyeja. Unë sygjeroj që të punojmë së bashku, qështjet të cilat i kemi me Halilin apo me poziten na takojnë neve, sigurisht që ne nuk pajtohemi nganjëher dhe kur e kanë mirë këta ne nuk pajtohemi kjo është qështje puro politike.

Argjend Thaçi: Kontakti që kam pasur me Vetonin kam thënë që nëse jeni 15 asambleistë unë vi e vazhdoj seancën. Unë kam qenë korrekt me të gjithë anëtarët e kuvendit.

Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Në mandatin e kaluar e dimë që shpesh herë kryesuesi i kuvendit ka qenë në presion për arsye të asambleistëve, por unë kam deklaruar që kryesuesi i kuvendit në këtë mandat

nuk ka asnjë lloj presioni nga grupi NISMA social-demokrate . Kryesuesi i kuvendit ka me e përfunduar detyrën siç e thotë ligji për qeverisje lokale dhe rregullorja e kuvendit të komunës. Nebihi ka të drejtë kur thotë që Kryesuesi i kuvendit duhet ta vazhdojë seancën nëse ka antarë të kuvendit që dëshirojnë me vazhdu seancën, por ta sqarojmë një gjë mirë se përse është anuluar seanca. Kur është ndërpre seanca deputetët e opozitës kanë kërkuar me vazhdu seancën me një pikë tjetër, punë e cila nuk bëhet ligjërisht në atë pikë ku është ndërpre aty duhet të vazhdohet. Ne kemi qenë të gatshëm të ja fillojmë në atë pikë ku kemi mbetur, është krejtësisht e arsyeshme qëndrimet politike qoftë të grupeve, qoftë të asambleistëve përshembull me cekë për këtë arsye politike dëshirojë të dal jashtë është legjitime. Anëtarët e kuvendit të cilët kanë dalë jashtë është legjitim por mbledhja është anuluar për arsye që anëtarët e kuvendit kanë thënë që nuk kanë qenë të ftuar për mbledhjen e cila është mbajtur, ftesa nuk i është shkuar për arsye teknike, por kanë qenë të njoftuar një ditë para dhe nuk janë ardhë. Kryesuesi i Kuvendit nuk ka dashur të mbajë seancë pa qenë ju, ju ka dërguar email për arsye teknike nuk ju është ardhur faji i Kryesuesit është, edhe nëse ju kish ardhur emaili ju prap nuk kishi ardhur. Pra, kjo seancë nuk është anuluar për arsye të vendimeve të cilat i kemi marrë të pa ligjshme por për arsye të një punë teknike.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot Gashi!

Labinot Gashi: Përshëndetje për të gjithë!

Unë nuk desha ta marrë fjalën por pasi që u debatu qështja e mbledhjes së fundit, unë po ju lus si kolegë sidomos mazhorancës me ruajt dinjitetin e Kuvendit. Unë jam nënshkruar i ankesës, nuk ka të bëjë kjo as për qështje personale, as për inati. Kemi kërkuar dokumentacion shtesë dhe nuk na ka ardh dhe kemi dhënë qëndrim politik, kemi dalur për atë pikë nëse i shihni praktikën e parlamentit të Kosovës edhe aty kemi mazhorancë por nganjëher nuk ka korum dhe ajo pikë bartet për seancën tjetër. Ne kemi qenë prezent në seancë 6 orë, dhe në mënyr arbitrale është marrë lista, janë shkuar në konsultim dhe seanca është ndërpre. Mu më ka ardhur emaili dhe i kam treguar Kryesuesit që nesër nuk jamë prezent për arsye familjare, me datë 30 nuk kamë pasur informacion që do të mbahet sepse do kisha ardhur me e mbajtë një qëndrim. Po ju lus me ruajt dinjitetin e kuvendit sepse pushtetet janë të ndara, ne thjesht kemi kërkuar sqarim dhe atë ditë problemet që i kemi ngritë i kemi marrë, dhe shqetësimet e qytetarëve dhe askush nga ekzekutivi nuk ka qenë prezent me na dhënë sqarime ose me ju përgjigj pyetjeve që ne si asambleistë i kemi drejtuar te ekzekutivi.

Argjend Thaçi: Kërkoj nga ekzekutivi që të përgjigjet në qështjet që u ngritën nga anëtarët e Kuvendit. Drejtori i urbanizmit Avdi Morina e ka fjalën!

Avdi Morina: Përshëndetje për të gjithë!

Po përgjigjem në pyetjen e parë që e bëri Nebihi, realisht ne e kemi një kontratë sa i përket trajtimit ose realizimit të projektit të rrugës "Ibrahim Mazreku" për arsye të kushteve klimatike nuk kemi filluar me punime, sepse jemi akoma në sezonin e dimrit dhe janari mund të jetë i papritur dhe për mos të krijuar tollovi sidomos për bizneset nuk kemi filluar të kemi punime më tutje. Ajo çka është me rëndësi rruga dhe pse për shkak të reshurave që po shkakton probleme në

komunikacion, kompania vazhdimisht është duke e trajtuar dhe realisht për arsye të reshurave të shiut po eliminohet.

Pyetja tjetër i nderuar lirisht mundesh me ardhë në zyre dhe të shikosh a janë në kuadër të listave apo nuk janë dhe nuk ki nevoj të bësh kërkes, unë e di që kemi jashtëzakonisht kërkesa të mëdhaja për ndërtime dhe fatkeqësisht është një fakt që Malisheva për arsye të disa zonave nuk e ka të rregulluar me planë një plan urbanistik dhe ne jemi hasur në vështirësi mirëpo realisht ne po mundohemi që në bazë të kriterëve të cilat i përcakton ligji ato ndërtime të lejohen. Tash jemi në finalizim të hartave zonale i kemi dërguar dhe vendet shtesë që janë kërkuar nga Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapsinor. Jemi të interesuar që sa më shpejt ministria të na aprovojë hartën zonale dhe menjëherë të përgatitet shpallja për plane rregulluese për disa zona në Komunën e Malishevës për arsye se të humbet dhe hapsira dhe të parashihen dhe rrugët dhe të gjitha gjërat. Nëse kuvendi merr ndonjë vendim që të mos lejohen këto lloje ndërtime edhe ne si Drejtori e zbatojmë këtë vendim.

Argjend Thaçi: Urdhëro Drejtoresha e Arsimit e ka fjalën!

Arbëresha Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë!

Veton të falenderoj për angazhimin që e ke, i falenderoj dhe stafin arsimor dhe nxënësit që po kontribojnë që të jetë arsimit më i mirë në komunën e Malishevës. Mendoj që jemi në rrugën e duhur edhe pse kemi dhe punë të tjera për tu bërë, por jam e bindur dhe e sigurt që puna dhe angazhimi jonë është që t'i kontribojmë përfundimisht Komunës së Malishevës, konkretisht arsimit në Komunën tonë. Pyetja për Qerdhet, Drejtorët dhe për paisje me letër shkollore, ne kemi pasur probleme me kontratën që e kemi bërë për furnizim për letër dhe toner, unë kam bërë vërejtjet e mia në email te zyrtarët e kompanis së tyre dhe përgjigjia e tyre ka qenë që kanë munges të paisjeve. Tashmë ka filluar furnizimi në shkolla tona për letër e do të vazhdon me mjete tjera kompetizimit.

Jemi në përfundim e sipër të punimeve administrative të shpalljes së konkursit për staf në qerdhet në Malishevë dhe në Kijevë. Është e vërtet që kemi pasur kërkesa të pa ndalshme në gjitha drejtimit, kërkesat tona kanë qenë që të na lejohet numri fizik për me funksionalizu qerdhen në Malishevë. Objektivist Komuna i ka përfunduar shërbimet e veta, i ka ndërtuar dy qerdhe një të një në Malishevë dhe tjetrën në Kijevë dhe ka muj të tër që nuk kemi mundur me funksionalizu si rezultat i mos lejimit të numrit fizik të puntorëve. Kërkesat tona të vazhdueshme kanë reflektuar që të na lejohet një numër puntorësh fizik dhe pse jo numri që ne kemi kërkuar të jetë, por është një numër minimal puntorësh fizik që ne e kemi shpallur konkursin dhe do të fillojmë me këta puntorë të cilët i plotësojnë kushtet të cekura në konkurs. Jemi pa inventar në qerdhen e Kijevës dhe kjo do të rregullohet shumë shpejtë, si objekt është një nga objektet i cili i ka plotësu kriteret tjera përjashtimisht që ne po bëjmë përpjekje ta furnizojmë atë qerdhe me inventarë.

Qështja e Drejtorëve ka përfunduar konkursi, komisioni ka konklodur që konkursi më shumë ka pasur plotësim të korumit që tash ka ndërru një kualitet të personave të cilët do të jenë Drejtorë. Nuk kemi cilësi kemi më shumë korum dhe kemi marrë vendim që të anulohet ai konkurs. Tash e

tutje do të shohim se si do të veprohet, do të jetë e mundshme që në këta muajt në vijim do të shkojmë me ushtrues të detyrës deri në vendim që Drejtoria e Arsimit të jetë e gatshme me shpall konkursin dhe me i rekrutu njerzit që janë kredibil për me udhëheq institucione arsimore. Ju faleminderoj për bashkëpunimin.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nënkryetar!

Vesel Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë!

Ne kemi reagu përmes facebook-ut por ata që duhet me deklaruar janë bartësit e institucioneve në nivel qendror. Ne e kemi ndjek me shqetësim dhe deklaratat e ministrit të financave kanë qenë jo serioze sepse me ligj përcaktohet. Vlerësimi i pronave bëhet çdo tri vite dhe këtë e bënë ministria e financave përmes departamentit, ndërsa norma përcaktohet nga niveli lokal. Ju e dini që kemi miratu dhe këtu për me bërë tatimin në pronë norma minimale që kemi caktuar ka qenë 0.15% dhe asociacioni i komunave përmes kryetarëve e ka përpiluar një draft që ka kërkuar të hiqet edhe kjo normë sepse ka komuna edhe në këtë nivel, ka qenë një tarif plus dhe minus nga 0.15 deri në 1. Çka ka ndodhë në vitet e kaluara, ka ndodhur vazhdimisht një ngritje 20%-30%, por kjo që ka ndodhë 100% në një situatë ku jemi në një krizë nuk do duhej të kemi një ngritje kaq të lartë. Kjo ka qenë arsyeja që kanë reagu qytetarët por procedurat ligjore janë këto, Ministri Murati është deklaruar që kërkoi fajin te Komuna por jo vlersimin komuna nuk e ka bërë, e bëri Ministria e Financave gjegjësisht digasteri i tatimit në pronë. Normat i përcakton Komuna dhe ato norma jeni ju ata të cilët e keni votuar, por vlerësimi ka qenë i pa nevojshëm me një ngritje të tillë, përdërisa nuk kemi ngritje të pagave, nuk kemi subvencionim të bizneseve, nuk kemi asnjë lëvizje, as një politik nuk është marrë në favor të bizneseve. Ne konsiderojmë që ka qenë një vlersim aq i lartë i pa nevojshëm

Argjend Thaçi: Faleminderit shumë Nënkryetar, meqenëse u zgjodhen qështjet e ngritura, atëherë të pranishëm në kuvend jemi 26 anëtarë. Kalojmë te rendi i ditës përveq pikave që janë në rend të ditës unë propozoj që pikat e mbledhjes së datës 30.01.2023 ti fusim si pika të rendit të ditës të cilat janë:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/300 datë: 07.12.2022, e parashtruar nga Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe pronë për miratimin e listës së pronave të palujtshme të Komunës.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1742 datë: 11.10.2022, e parashtruar nga bashkësia islame në Malishevë për vazhdimin dhe plotësimin e kontratës për shërbimet e varrimit
3. Shfuqizimi i vendimit nr. 02/319 datë: 30.06.2022 për ndarjen e mjeteve financiare për klubin e futbollit FC“Malisheva” në Malishevë, sipas kërkesës së MAPL-së nr. 020-607/1 datë 12.07.2022.
4. Shfuqizimi i vendimit nr.02/499, datë: 23.10.2022, sipas kërkesës së MAPL-së nr. 020-945/6 datë: 02.11.2022.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/598 datë: 01.12.2022

6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/629 datë 19.12.2022
7. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/594 datë: 29.11.2022
8. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/602 datë: 01.12.2022
9. Lulëkuqja me 4 petale të bëhet simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë.

Këto pika i hedhi në votim si tërësi që të jenë si pika të rendit të ditës në mbledhjen e sotme.
Urdhëro, Nebih Bibaj!

Nebih Bibaj: Unë mendoj që këto pika është mirë me i fut një nga një, sepse dhe ne kemi kërkesa për rend të ditës dhe ndoshta ne nuk mundemi me thënë me i shti si total të gjitha. Unë e kam një kërkes me u fut në rend të ditës me i dal në ndihmë komunave të prekura nga vërshimet të cilat nuk janë pak, dhe dëmet e tyre janë shumë të mëdhaja. Besoj që ne si komunë me një shumë solidarë të ju dalim në ndihmë këtyre qyteteve për arsye se dhe ata kanë hapur llogari bankare që ne të i ndihmojmë. Drejtori i financave nëse mundet me na tregu se a kemi mundësi që t'i ndihmojmë këtyre Komunave, të ju caktohet një shumë e cila do të shkojë për secilën komunë që është e prekur nga këto vërshime.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Unë pajtohem me Nebihin që tha pikat me shku në votim një nga një të gjitha. Kryesues, po vazhdon me i bërë gabimet e njëjta dhe disa herë të kam thënë merre lexoje rregulloren, dhe konsultohu me rregulloren para se me marrë këso vendimesh. Nuk mundesh sot me ardhë vendimi nga MAPL dhe sot mbrenda seancës me i sjell 10 pika të rendit të ditës të cilat i ka rrxu vendimi i MAPL-së. Në rregullore shenon që ato pika të cilat nuk miratohen në Kuvend dhe del naj problem shtes duhet me shku në KPF dhe përmes KPF-së me ardhë prap në kuvend. Këtu e kemi juristin dhe nëse ai thotë që nuk është shkelje ligjore, atëherë mundesh edhe me vepru në këtë mënyrë.

Argjend Thaçi: Faleminderit Veton, urdhëro Halil Morina!

Halil Morina: Unë e kam një propozim për rend të ditës në cilësin e kryetarit të komisionit të aksionarëve, shoqëris aksionare të stacionit të autobusëve që një vit jemi duke u përballur me dorëheqje dhe zëvendësime të anëtarëve që na kanë pengu shumë me e përfundu punën tonë. I kemi pasur tre ndërrime dhe çdo ndërrim na ka marrë nga dy muaj dhe kjo na ka penguar në punën tonë. Meqë një anëtarë i përfaqësuesit të kryetarit ka dhënë dorëheqje unë propozoj që të hiqet si pikë e rendit të ditës: Zëvendësimi i një anëtari të komisionit të aksionarëve stacioni i autobusëve Malishevë.

Sa i përket kësaj që u deklarua nga Nebihi dhe Vetoni, MAPL e ka kthi pikën që e kemi marrë vendimin në mënyrë të pa ligjshme. MAPL e ka anuluar seancën për arsye të mos njoftimit të anëtarëve të kuvendit, pra pika nuk ka asnjë problem ligjor, pika vazhdon dhe hynë si pikë e re në rendin e ditës. Të gjitha këto pika janë votuar pro dhe nuk ka nevoj të kthehen prap në KPF, në mënyr ligjore kur Kuvendi e ka mbajtur seancën ka pasur korum, problemi është që nuk janë njoftuar disa anëtarë të kuvendit kjo është arsyeja përse është anuluar. Kush dëshiron me tentu

me blloku punën e kuvendit letë vazhdon gjatë gjithë kohës, ne kemi me u përpjek me i shty përpara punët e kuvendit.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih Bibaj!

Nebih Bibaj: Unë nuk po mundem një gjë me kuptu, nuk ka rëndësi se kush është në pushtet ju apo ne, procedurat janë procedura, ne po flasim për procedura këto kërkesa të cilat kanë ardhë sot me vendim që ne ende fizikisht nuk e kemi pranë dhe nuk e sjell vendimin për qfarë arsye është kthyer në pikën zero kjo seancë dhe t'i insiston. Pse po insiston thirrë mbledhjen e jashtëzakonshme thirrë KPF-në përmes KPF-së e cakton seancën tjetër por nuk mundesh kështu në këtë formë sot vendimi sot i sjell pikat në rend dite. Respektoni procedurat sepse tani po thoni pse po bëni ankesë, mos na lejoni të bëjmë ankes por përfundoni procedurat.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Arsyeja përse po kërkoj me hy këto pika është pikërisht kjo që po thu nuk po na ngutet, po na ngutet sepse kemi dhe punë të tjera për mos me i bë problem askujt me ardhë dhe në një seancë të jashtëzakonshme. Nëse këtu ka problematika ligjore nuk është që jemi të interesuar me u lodh dhe prap me u kthyer mbrapa, për këtë unë pres nga anëtarë ligjor me dhënë një interpretim ligjor nëse ka problematika ligjore ne nuk i fusim në rend dite. Ne këtu jemi me përfunduar punë sa ma shpejt sa më reale pa shkelur procedura ligjore.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Unë e lus Muharremi me dal me na shpjegu, sepse praktikat e secilit kuvendit, por dhe kuvendi i Republikës së Kosovës nëse mbesin pikat e rendit të ditës atë seancë nuk mundesh me i fut në seancën tjetër pakaluar në kryesin e kuvendit. T'i e ke pregadit rendin e ditës dhe anëtarët e kuvendit janë ardhë me i ekzekutu këto pika nëse ka ndonjë pikë të jashtëzakonshme nëse vjen përmes kryetarit diskutohet a me hy apo jo ose ndonjë propozim konkret siq e bëri Nebihi. Nuk mundesh komplet pikat e një seancës që kanë mbetur me të papërfituara me i fut në seancën të cilën sot jemi duke e mbajtur nuk mundesh me ngarku në këtë mënyrë pa kaluar ëshë një herë në KPF. E thërret KPF-në, e thërret seancën e jashtëzakonshme i diskutojmë rend një nga një pikat.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban Kastrati!

Alban Kastrati: Unë nuk deshta me politizu këtë temën e senacës të kaluar që e kemi mbajtur, mirëpo po e shoh që prap po i silleni atyre procedurave. Gjithqka ka filluar për mos zbatim të procedurave seanca tyë cilën e keni mbajtur ju para vitit të ri që i bije vitin e kaluar, ka qenë mos përfillje e procedurave. Është bërë shkelje kur nuk jemi ftuar ne si asambleistë, është bërë përjashtim komplet i asambleistëve të opozitës. Kryesues je i obliguar me i thirrë asambleistat a vin apo jo është përgjegjësi e tyre. MAPL e ka kthyer për arsye të shkeljes së procedurave përdoret një term Juristat e dinë: restitutja e integrum pra kthehen në pikën zero përsëritet.

Gjithqka kthehet në pikën zero edhe në këtë rast kthehet në KPF, KPF-ja e sqaron dhe një her mirë ja rekomandon Kuvendit dhe pastaj kuvendi vazhdon me punimet hudhen në votim këto janë qështje procedurale.

Argjend Thaçi: Fjalen e ka zyrtari ligjor, Muharrem Morina!

Muharrem Morina: Përshëndetje për të gjithë!

Qështja nuk ka të bëjë me seancën, ka të bëjë me vazhdimin, ministria ka kërkuar që shkresës që po i referohem është me datën 20.01.2023 e hartuar nga i 18, dhe thotë e bazuar në raportin e monitorimit të komunave vazhdimi i mbledhjes së kuvendit të Komunës është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për vazhdimin e mbledhjes duhet të njoftohen të gjithë anëtarët dhe ministria e pushtet lokal ashtu siq është përcaktuar nga neni 43.3 si dhe neni 43.5 të ligjit për vet qeverisje lokale. Këtu ka të bëjë me vazhdim të seancës nuk ka të bëjë me seancën komplet, të gjitha vendimet që janë marrë me datën 28.12.2022 janë valide, ato vendime që janë marrë me datën 30.12.2022 janë të pa vlefshme. Është shumë e pa arsyeshme me nxjerr vendime të reja pa i votuar ato, ne këto vendime nuk mundemi me i anuluar në qoftëse nuk i shtijmë në këtë seancë, sepse në këtë seancë kanë me u marrë vendime të reja. Ajo qka po mendon ti Veton me u kthi në komitetin për politik dhe financa është një standart që e ka krijuar mandati i kaluar i anëtarëve asambleist por ligji nuk e thotë, për arsye se Ministria e pushtetit lokal i drejtohet organit që e ka marrë vendimin në këtë rast shkeljet kundra nga asamblea. Këtë shkelje ne mundemi me përmisu në qoftë se këto pika i shtim sot në rend të ditës dhe i votojmë përsëri, votimi përcakton Pro-Kundra është qështje personale. Secili vendim që mirret do ta shfuqizon një vendim tjetër që është marrë me datën 30.12.2022 sepse të gjitha ato vendime janë në MAPL. Komiteti për Politik dhe Financa nuk është organ që e krijon rendin e ditës, rendin e ditës e krijon kryetari dhe kryesusi.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nënkyetar!

Vesel Krasniqi: Një sqarim rreth një kërkesë që Nebihi e ceki për me i dal në mbështetje komunave të prekura nga vërshimet, kam biseduar me Kryetarin me pamundësi e kemi marrë një iniciativ vullnetare sepse ende buxheti nuk na është lejuar me pas në shfrytëzim. Ajo qka ne kemi menduar me bërë është vler buxhetare dhe me i pas sigurisht te rendi i ditës propozimet mënyra e ndihmës bëhet kështu. Mënyra të tjera nuk ka të drejt sepse është qeveria e Kosovës për me i mbështet të prekurit, të lënduarit nga vërshimet ne duhet të i mbështesim me pako ushqimore ose me veshmbathje dhe që duhet një vendim në qfar vlere dhe me ja fillu procedurave. Me i mbështet me mjete monetare Komuna duhet me pas kërkesa individuale të secilit për ndihmë.

Argjend Thaçi: Faleminderit Nënkyetar, shkojmë te propozimet i hedhim një nga një. Pika e parë është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 06/300 datë: 07.12.2022 e parashtruar nga Drejtoria për gjeodezi, kadastër dhe pronë për miratimin e listës së pronave të pa luajtshme të Komunës. Kush është për?

Për: 17

Kundër: 11

Abstenim: 1

Me 17 vota për, 11 kundër dhe 1 abstenim, kjo pikë hynë si pikë në rend të ditës.

Pika e radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1742 datë: 11.10.2022, e parashtruar nga bashkësia islame në Malishevë për vazhdimin dhe plotësimin e kontratës për shërbimet e varrimit. Kush është për?

Për: 26

Kundër: 0

Abstenim: 3

Me 26 vota për, asnjë kundër dhe 3 abstenime, kjo pikë hynë si pikë e rendit të ditës.

Pika e radhës është: Shfuqizimi i vendimit nr. 02/319 datë: 30.06.2022 për ndarjen e mjeteve financiare për klubin e futbollit FC "Malisheva" në Malishevë, sipas kërkesës së MAPL-së nr. 020-607/1 datë 12.07.2022. Kush është për?

Për: 18

Kundër: 0

Abstenim: 11

Me 18 vota për, asnjë kundër dhe 11 abstenime, kjo pikë hynë si pikë e rendit të ditës.

Pika e radhës është: Shfuqizimi i vendimit nr.02/499, datë: 23.10.2022, sipas kërkesës së MAPL-së nr. 020-945/6 datë: 02.11.2022. Kush është për?

Për: 17

Kundër: 1

Abstenim: 11

Me 17 vota për, 1 kundër dhe 11 abstenime, kjo pikë hynë si pikë e rendit të ditës.

Pika e radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/598 datë: 01.12.2022
Kush është për?

Për: 23

Kundër: 0

Abstenim: 5

Me 23 vota për, asnjë kundër dhe 5 abstenime, kjo pikë hynë si pikë në rendin e ditës.

Pika e radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/629 datë 19.12.2022.
Kush është për?

Për: 23

Kundër: 0

Abstenim: 5

Me 23 vota për, asnjë kundër dhe 5 abstenime, kjo pikë hynë si pikë në rendin e ditës.

Pika e radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/594 datë: 29.11.2022.
Kush është për?

Për: 22

Kundër: 0

Abstenim: 6

Me 22 vota për, asnjë kundër dhe 6 abstenime, kjo pikë hynë si pikë në rendin e ditës.

Pika e radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/602 datë: 01.12.2022. Kush është për?

Për: 23

Kundër: 0

Abstenim: 5

Me 23 vota për, asnjë kundër dhe 5 abstenime, kjo pikë hynë si pikë e rendit të ditës.

Pika e radhës është: Lulëkuqja me 4 petale të bëhet simbol unik përkujtimor i Gjenocidit në Kosovë. Kush është për?

Për: 26

Kundër: 0

Abstenim: 3

Me 26 vota për, asnjë kundër dhe 3 abstenime, kjo pikë hynë si pikë e rendit të ditës.

E kemi dhe propozimin e Halilit që është: Zëvendësimi i antarit bordit të aksionarëve të stacionit të autobusëve në Malishevë. Kush është për?

Për: 23

Kundër: 0

Abstenim: 6

Me 23 vota për, asnjë kundër dhe 6 abstenime, kjo pikë hynë si pikë e rendit të ditës.

Propozimi i Nebihut është: Shqyrtimi i mundësisë së gjetjes për ndihmë financiare nga kuvendi komunal i Malishevës për Komunat e prekura nga vërshimet. Kush është për?

Unanimisht ky propozim i Nebihut hynë si pikë e rendit të ditës.

E hedhim rendin e ditës në votim si tërësi me plotësim-ndryshime. Kush është për?

Për: 18

Kundër: 3

Abstenim: 8

Miratohet rendi i ditës për këtë mbledhje. Faleminderit të gjithëve për kontributin e dhënë.

Vazhdojmë me pikën e parë e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të datës 28.12.2022. Kush është për?

Në mënyrë unanime, konsideroj që është votuar kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e dytë është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 06/300 datë: 07.12.2022, e parashtruar nga Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe pronë për miratimin e listës së pronave të palujtshme të Komunës. Urdhëro Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Do isha kundër për me votuar këtë pikë por vetëm desha një sqarim me qenëse u votua rendi i ditës, sipas ligjit komuna është e obliguar deri me 31.12 me paraqit listen e pronave, qka ndodhë nëse votohet kjo pikë e rendit të ditës?

Argjend Thaçi: Faleminderit Veton, këto sqarime i kemi bërë. Kush është për?

Për: 17

Kundër: 11

Abstenim: 0

Miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1742 datë: 11.10.2022, e parashtruar nga bashkësia islame në Malishevë për vazhdimin dhe plotësimin e kontratës për shërbimet e varrimit. Edhe për këtë pikë kemi shterr debate mjaftueshëm. Kush është për këtë pikë të rendit të ditës?

Për: 25

Kundër: 0

Abstenim: 3

Miratohet dhe kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e radhës është: Shfuqizimi i vendimit nr. 02/319 datë: 30.06.2022 për ndarjen e mjeteve financiare për klubin e futbollit FC "Malisheva" në Malishevë, sipas kërkesës së MAPL-së nr. 020-607/1 datë 12.07.2022. Kush është për?

Me vota unanime, konsideroj që kjo pikë është aprovuar.

Pika e radhës është: Shfuqizimi i vendimit nr.02/499, datë: 23.10.2022, sipas kërkesës së MAPL-së nr.020-945/6 datë: 02.11.2022. Kush është për?

Me vota unanime, konsideroj që është miratuar kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/598 datë: 01.12.2022. Urdhëro Halil!

Halil Morina: Meqenëse i kemi 4 kërkesa të natyrës së njëjt, varësisht vendimin qysh e kemi marrë në sëancën e kaluar me i nda 2000.00E për secilin të mos vonohemi të i miratojmë të gjitha së bashku.

Argjend Thaqi: Atëherë kush është për miratimin e këtyre kërkesave meqenëse janë të natyrës së njëjt me ju nda nga 2000.00E:

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/598 datë: 01.12.2022 .

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/629 datë 19.12.2022.

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/594 datë: 29.11.2022.

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/602 datë: 01.12.2022.

Faleminderit shumë me vota unanime konsideroj që të gjitha këto kërkesa janë aprovuar.

Argjend Thaçi: Urdhëro Nebih!

Nebih Bibaj: Kërkesat të cilat na vinë të shfuqizuara mundësisht na i sjellni fizikisht, që ne si anëtarë të kuvendit të dimë se përse është shfuqizuar një kërkesë.

Argjend Thaçi: Në rregull, kemi pikën e radhës të rendit të ditës e cila është: Lulëkuqja me 4 petale të bëhet simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë. Është bërë praktik e gjitha kuvendeve Komunale dhe shumica e kanë miratuar këtë kërkesë. Kush është për?
Me vota unanime, konsideroj që miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e radhës është: Zëvendësimi i anëtarit të Bordit të aksionarëve të stacionit të autobusëve në Malishevë. Urdhëro Halil!

Halil Morina: Në emër të Kryetarit të Komunës po e propozoj meqë anëtarja e komisionit që ka qenë e dërguar nga zyra e Kryetarit znj. Donjeta Stollit ka dhënë dorëheqje, unë propozoj kjo anëtare të zëvendësohet me Blerta Krasniqi si anëtare e re e komisionit të stacionit të autobusëve në Malishevë.

Argjend Thaçi: Faleminderit Halil, e hedhi në votim propozimin e Halilit kush është për?

Për: 17

Kundër: 7

Abstenim: 5

Miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e radhës është propozimi i Nebihit: Shqyrtimi i mundësisë së gjetjes për ndihmë financiare nga kuvendi komunal i Malishevës për Komunitet e prekura nga vërshimet. Urdhëro Nebih!

Nebih Bibaj: Pas sqarimit të Nënkryetarit dhe Drejtorit që ne nuk kemi të drejtë me ju qit mjete direkt në konto të Komunave, atëherë ne e bëjmë një pako të Komunave qoftë ushqimore apo veshëmbathje me një vlerë që do ta caktojmë së bashku dhe në këtë formë që tu ndihmohet. Mjetet ndahen nga buxheti dhe sigurisht do të hapet një tender dhe ju ndihmohet në këtë formë. Me pajtimin e Kryetarit vlera e kësaj shume është 10.000E për ndihmë qoftë ushqimore qoftë veshëmbathje.

Argjend Thaçi: E hedhi në votim propozimin e Nebihit që shumën prej 10.000E të ndahen pako ushqimore për familjet e prekura nga vërshimet e fundit në Republikën e Kosovës. Kush është për?

Me vota unanime, është aprovuar dhe kjo pikë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikat e radhës e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës së Kuvendit për vitin 2022. Ajo që është e rëndësishme për gjatë këtij viti është që ka pasur një volum mjaft të madh të punës së Kuvendit, gjithsej 132 vendime, 5-rregullore, 10-seanca të rregullta të mbajtura, 3-të jashtëzakonshme, 2-urgjente që gjithsej janë 15-seanca duke mos i llogaritur dhe seancat solemne dhe mbledhjet përkujtimore që kanë qenë. Të gjitha datat e mbajtjes së

mbledhjeve i keni të shenuara në raport. Vlen të ceket që në këtë legjislator janë miratuar dy projekt-buxhete pasi që për vitin 2022 nuk ishte miratuar sipas afateve kohore.
Urdhëro Amrush Helshani!

Amrush Helshani: Ju përgëzoj për këtë raport juve dhe zyrës së Kryesuesit, pasi që Komitetit për Komunitete është Komitet i rregullt obligativ dhe sigurisht që Komiteti për Politikë dhe Financa ka punë të tjera dhe janë pasqyruar punët dhe obligimet qka i kemi nxjerr gjatë vitit. Ndërsa Komiteti për Komunitete keni shenuar që janë mbajtur 11 mbledhje, ka qenë mirë që në këtë raport të përfshihen rekomandimet e këtij komuniteti të jenë pjesë e këtij raporti.

Argjend Thaçi: Komiteti për Komunitete e ka raportin e vet, ndërsa KPF e ka në kuadër të punës së Kuvendit pra nuk ka raport të veçantë, për këtë arsye nuk është shkuar në zgjerime të aktiviteteve të komitetit për komunitete meqenëse e keni raportin e juaj si komunitet.

Pika e radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të Komitetit për Arsim, Kultur, Rini dhe Sport kemi anëtarët e këtij komiteti dëshironi me dhënë ndonjë sqarim apo jo?
Urdhëro Fjoralba Dobruna!

Fjoralba Dobruna: Përshëndetje për të gjithë!

Raportin e Komitetit për Arsim, Kultur, Rini dhe Sport besoj të gjithë e keni parë. Ky raport nuk mund të jetë dhe arsyet i dimë. Kryesuesit të këtij Komiteti i kam dhënë sygjerrime për ndryshim apo përmisim të këtij raporti por siç po shihet nuk i ka marrë si këshilla dhe nuk ka bërë ndryshim. Unë si anëtare e këtij Komiteti nuk e kam votuar këtë raport po ashtu dhe kolegu jonë Hasimi. Meqenëse e kemi kolegën Arbnoren që e ka votuar këtë raport mundet ajo me prezantuar këtë raport nëse dëshiron. Faleminderit.

Argjend Thaçi: Urdhëro Labinot Gashi!

Labinot Gashi: Përshëndetje për të gjithë!

E kam lexuar raportin për arsim ajo çka është shqetësuese për mua, Drejtoresha e pranoj problemin në arsim. Të paktën ky Komitet i Arsimit është dashur me ardhë me përfundime konkrete, problemet i dimë cilat janë në arsim shpesh herë ne po e paraqesim gjendjen shumë të mirë në arsim dhe realisht raporti tregon që nuk është mirë. Ka mungesë të kushteve elementare, mjeteve të konkretizimit. Që 4 vite janë shkollat e Malishevës pa Drejtor dhe Drejtoresha thotë të vazhdojmë dhe pak me ushtrues të detyrës kur çdo mundësi ligjore në këtë aspekt është e konsumueshme. Nuk ki të drejt me lënë 4 vite ushtrues të detyrës një person, duhet me u zgjidh ky problem.

Unë kam pritur nga Komiteti rekomandime konkrete, por shihet në raport që nuk ka raporte bashkëpunuese në mes komitetit dhe Drejtoreshës dhe kjo është shqetësuese. Të paktën tri ose katër rekomandime është dashur me i sjellë në Kuvend.

Argjend Thaçi: Urdhëro Halil Morina!

Halil Morina: Vetëm një citat të këti raporti po e ceki: Shkuam ne DKA na pritën mirë , na lutën dhe për kafe. I gjithë raporti është me këto të dhëna. Dy qështje tjera që aty ngriten që i ceki Labi, shqetësimi më i madhë është se sa mbledhje paguhen në këtë Komision. Kjo është shqetësim për neve sepse është angazhim i madh shtes dhe po duhet me humbë kohë pa asnjë lloj kompenzimi dhe prap se prap ne duhet të i përfundojmë punët e Kuvendit sepse nuk duhet të lëjmë pa i përfunduar. E fundit disa prej rekomandimev të themi janë përpjekje të sulmuesit, nuk erdh ai nuk bashkëpunoj ai. Unë mendoj që nuk duhet me u votuar ky raport si anëtar i kuvendit as nga anëtarët e këti Komiteti që janë.

Argjend Thaçi: Urdhëro Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Përshëndetje për të gjithë!

Uroj që ky vit me qenë i mbarë për ju dhe familjet e juaja. Uroj që dhe kryesuesi të konsiderohet Kryesues me përvojë sepse ka përfunduar një vit.

Sa i përket raportit të Komitetit për Arsim ndoshta të gjitha emërtimet e tjera mund ta japin përveq Raportit jo, duke e marrë parasysh që raporti është një përmbledhje ekzekutive e ngjarjeve të cilat ndodhin gjatë një periudhe kohore të caktuar. Këtu nuk ka përmbledhje por këtu ka tendenca, thjesht procesverbale të cilat i kanë biseduar ata për rreth takimeve të cilat i kanë pasur ata. Nëse këtë raport e quajm raport dhe publikohet me të vërtetë është shumë qesharak dhe të gjithë do të tallen me ne.

Argjend Thaçi: Urdhëro

Gentianë Hoti : Përshëndetje për të gjithë!

Unë e kam lexu këtë raport dhe pse në KPF i kam dhënë vërejtjet e mia. Ky mundet me qenë gjithqka por raport nuk është i ngjanë një procesverbali. Ka shumë gjëra që më kanë shqetësuar në këtë procesverbal pika e parë është anulimi i mbledhjeve në momentin kur nuk ka qenë Drejtoresha prezent nëse janë të parëndësishëm njerzit që punojnë aty, nëse ata nuk pranohen në mbledhje pse janë ata aty. Unë e di që Drejtoresha i përgjigjet Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit nuk i përgjigjet Komitetit. Te rekomandimet e ceki dhe Labi njëri prej rekomandimeve ka qenë dhe trajtimi i Qendrës së Kompetencës unë e përgëzoj Drejtorinë e Arsimit që është ndihmu Qendra e Kompetencës dhe shkolla në Kijevë. Në kuadër të kësaj e kemi një numër të madhë të nxënësve Qendren e Kompetencës në Kijevë. Në fund e di që qështja e Arsimit është një fushë shumë e gjerë dhe kërkon trajtim më shumë, por unë kërkoj nga gjithë ju që së bashku të bëjmë punë të mira për arsim.

Argjend Thaçi: Urdhëro Mirëllinda Gashi!

Mirëllinda Gashi: Në bazë të këti komiteti, i cili e ka sjellë këtë raport mendoj që ky është realiteti që është gjendja në arsim në Komunën e Malishevës. Vetëm se jemi mësuar ne me na ardhë materiali me rubrika, na ka ardhur në një formë tjetër mirëpo gjendja reale është përshkruar ashtu që është diskutu. Drejtoresha kur e ka marrë detyrën si drejtoreshë e arsimit fjalën e parë e ka thënë pres bashkëpunim për me qenë gjendja e mirë dhe kur e thua këtë fjalë duhet me

bashkëpunu. Ky është komiteti i cili hulumton, del në teren dhe shumë e përgëzoj për punën që e bënë, hynë në çdo shkollë shikon gjendjen, mundet me ato të dhëna me depertu te DKA-ja që këta me pas si CV të komunikimit apo gjendjes reale në Komunën e Malishevës. Këtu janë shënuar disa shkolla të cilat janë vizituar nga ky Komitet dhe pamë që gjithë ato shkolla kanë munges të gjërave elementare për punë, nxemjet kanë pasur vërejtje, ka pasur vërejtje që nuk ka letër.

Drejtoresha tregoj që është nënshkruar një kontrat për letër, kontratat po nënshkruhen por po shkonë viti dhe nuk po hynë në funksion. Unë kërkoj nga Drejtoresha e Arsimit që të punojë dhe ta ketë një bashkëpunim me këtë komitet.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Unë këti raporti në KPF i kam dhënë vërejtjet e mia, i kam pasur disa sugjerime dhe për anëtarët e tjerë, nuk është bërë një raport siç duhet në bazë të standarteve siç e bëjnë komitetet e tjera mirëpo nuk duhet me mungu fakti që si Komitet kanë nxerr disa të dhëna që pasqyrojnë një gjendje reale të gjendjes së arsimit në komunën e Malishevës. Shqetësuese për mua është që pas disa tentimeve që kanë pasur si Komitet me taku Drejtoreshën e Arsimit nuk kanë mundur me taku. Nuk është mirë me injor qoftë edhe një person të pa dëshiruar në qoftë se i bënë dy apo tri këkesa për takim. Është komiteti i vetëm që përbëhet nga njerëzit profesional të fushës së arsimit, ndërsa raporti është bërë prej një personi. Unë kërkoj nga anëtarët e tjerë që në raportet e tjera në planet e ardhshme me u përfshi më shumë, sepse janë njerëz profesional. Rekomandimet pajtohem plotësisht me parafolësit që nuk janë rekomandimet e duhura, dhe nëse janë të gjitha ato vërejtje për kushtet e arsimit, rekomandimet duhet me qenë më specifike se qfarë kërkojnë që të përmirsojnë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot Gashi!

Labinot Gashi: Raporti e pasqyron gjendjen reale në shkolla të Komunës së Malishevës dhe sa më shumë që i mbulojmë të metat ne kemi me gabuar më shumë dhe nuk mundemi me akuzu Kryesuesin e Komitetit që si një problematikë në arsim.

Te rekomandimet, ka rekomandime për qështjet që i ndihmojnë dhe drejtoris shumë, ne po e dimë gjendjen reale e pranoj dhe Drejtoresha mungesa e udhëheqësve në shkollë, te qështja e regjistrimit, qështja e Kompetencës është punë e definuar që e cekim kolegial që është adresuar. Kjo është në Komunë të Malishevës por menaxhohet nga Ministria, i ka kushtet shumë më të mira se do shkolla të tjera që i kemi. Çka na mungon neve për gjëra elementare është qështja dhe te procedurat e prokurorit, secila shkollë e ka buxhetin e ndarë por a menaxhohet mirë, jo, për arsye se ata udhëheqës që e menxhjojnë nuk e kanë buxhetin të cilin e menxhjojnë vet. Raporti është real e pasqyron gjendjen reale, i ngrita shqetësimet dhe rekomandimet që i ndihmojnë me qenë shumë më profesional dhe i ndihmojnë dhe drejtorisë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Driton Kastrati!

Driton Kastrati: Përshëndetje për të gjithë!

Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport është votuar në këtë asamble dhe i ka të gjitha kompetencat dhe autoritetet me dhënë vlerësime. Kryetari i Komitetit është një figurë e dëshmuar e arsimit dhe më gjerë. Ne të gjithë e dimë që ka parregullsi në shkolla dhe rekomandimet kanë qenë pak a shumë selektive me gjetë vërejtje të vogla apo të mëdha. Nuk mundemi me paragjyku si me pas ndoonjë tendenc në lidhje me Drejtoreshën, pra tendenc nuk ka pasur nëse ka gjetur vërejtje të higjiena, të gjërat e tjera. Këto rekomandime që kanë dalur nga ky komitet duhet me i marrë parasysh jo vetëm ne por dhe Drejtorit përkatëse të Arsimit.

Argjend Thaçi: Urdhëro Drejtoreshë!

Arbëresha Krasniqi: Faleminderit për mirëkuptimin tuaj, për arsye të agjendave të cilat i kam nuk mund të jem pjesë e seancës mbas pauzës dhe kërkoj mirëkuptimin tuaj. Duke respektuar punën e Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport të gjithë anëtarëve të këtij Komiteti, e vlerësoj shumë që i kanë bërë vizitë shkollave, e vlerësoj shumë qdo rekomandim. Unë pajtoj që nuk është bërë në suaza të një raporti i cili nuk quhet raport, por megjithë atë dua ta marrë si të mirëqenë. Të gjithë ata të cilët punojnë në sektorin e Arsimit e dinë edhe vet Prof. Januz i cili ka qenë Drejtor i Gjinnazit e dinë si ka qenë Gjinnazi kur ka qenë ai më herët dhe si është gjinnazi tash. Unë jam e bindur që nëse lexohet ky procesverbale edhe nga vetë anëtarët e këtij Komiteti kanë me e pa vetën dhe votimin e tyre në kundërshtim të asaj që quhet raport. Megjithatë e respektoj punën e secilit që bëhet në drejtim të hapave pozitiv për me përsmiauar gjendjen në Arsim. Të jeni të bindur që shkollat në Komunën e Malishevës i kam vizituar personalisht unë, nuk ka shkollë në Komunën e Malishevës të cilën nuk e kam vizituar dhe e di saktë se qysh është gjendja dhe për mem treguar Komiteti se qka ka pasur në një shkollë. Nuk e kam pasur të arsyeshme të jem pjesë e këtyre takimeve megjithëse në shumicën e rasteve i kam arsyet e mia të agjendave të tjera që nuk kam mundur të jem pjesë e takimeve. Unë e di që në takimin e parë me Kryesuesin e Komitetit në Drejtori të gjithë anëtarët e këtij Komiteti e kanë treguar Planin tim të punës njëkohësisht kam tri rekomandime për secilin takim, jo rekomandim të përgjithshëm të punës një vjeqare të raportit të këtij Komiteti por në secilin takim unë kam pritur që në secilin takim të vjen sado pak tre ose katër rreshta një raport i punës i gjendjes që ka konstatu ky Komitet.

Për mua puna nuk duhet të shkojë në këtë rrugë megjithë atë këtë e kanë zgjedh vetë anëtarët e këtij Komiteti dhe është qështje e tyre unë vetëm një e di nga përvoja ime që e kam në asamblen Komunale të Malishevës e di që Komiteti rekomandon nuk shpjegon se qka ka ndodhë.

Rekomandimi i tyre ke higjiena në shkolla kurr nuk ka pasur shkolla më të pastërta, a kemi nevojë ende plotësisht pajtona që kemi nevojë por e di që më pastër ambientet shkollore nuk kanë qenë kurr. E kemi një kontrat për renovim një prej kërkesave të asambleistës Donjetës është për në shkollën ku punon ajo, por këta punëtor dhe kjo kontrat nuk mundet me shku njëkohësisht në Carrallukë, në Tërpez, Damanek, Drenoc sepse kjo është një kompani që duhet me përfundu punën në Janar-Shkurt mandej vazhdon në shkollën tjetër pastaj në tjetrën. Përveq kësaj ne kemi një kontrat dy vjeqare që pretendohet që mbrenda dy viteve me i kry shërbimet e tilla. Ne jemi në

përpjekje të realizimit të kushteve më të mira në ambientet shkollore, është e pakuptimt me thënë një qështje të till, madje ne të gjithë e dimë se qështja e higjienës në shkolla nuk është vetëm puna që e bëjnë punëtorët teknik, nuk është vetëm ai që e furnizon me paisje higjienike por kemi dhe probleme me kanalizime në shkolla që dhe kjo duhet të ketë një tjetër kompani e që në fakt e kemi përzgjedh, qështjet e kanalizimeve të rregullohet në shkolla.

Është e pakuptimt kur unë dërgoj përfaqësuesin tim, shefin e Drejtoris së Arsimit dërgoj njerëz të cilët janë kompetent që në fakt unë punoj së bashku me ta dhe në mënyr të pakulturuar nuk i pranon komisioni në takim. Nuk mundet një Drejtor i Arsimit me realizu palnin e vet të cilin e ka parapa për 12 muaj e në fakt të shkon dhe të merret me 12 takime të komitetit për Arsim. Është e pamundur me marrë pjes në 12 mbledhje duke e marrë parasysh planin e punës i cili vjen para jush në kuvend. Unë pres angazhim nga të gjithë anëtarët e kët Komisioni që të sjellin sa më shumë rekomandime.

Qështja e letrës është zgjidhur dhe nuk ka munges të letrës tani.

Qështja e nxemjeve kur i ka vizituar profa Januz ndoshta kanë qenë të pa rregulluara, por tani në asnjë shkollë nuk ka probleme me nxemje.

Argjend Thaçi: Urdhëro Mirëllinda Gashi!

Mirëllinda Gashi: Drejtoresh, bashkëpunim me këtë Komisioni nuk paski, gjashtë mbledhje janë të rregullta ti duhesh me gjetë kohë me u taku me këtë Komitet dhe duhesh me marrë diqka prej tyre dhe me i dhënë, me pas një vijë bashkëpunimi. E ceke që nuk ka munges të letrës, nuk ka munges të higjienës, ka munges e nderuar sepse unë kam fëmijët në shkollë dhe i shoh. Ki mungesa të mjaftueshme ku unë blej letër sepse mësuesja thot që nuk ka letër dhe duhesh me ble. Ki probleme me nxemje shkolla në Llozicë nuk ka punuar tri ditë, për arsye të nxemjes. Ka probleme me të gjitha kjo kompania që shkon për mirëmbajtje të shkollave duhesh me bë kërkesen tani që mbas një viti me shku dhe me realizu përndryshe kurr nuk i kemi parë duke punuar.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Drejtoreshë Arbëresha Krasniqi!

Arbëresha Krasniqi: Mirëllinda, nuk mundesh me thënë që unë nuk jam takuar me Komitetin madje personalisht vetëm unë dhe prof. Januz kemi bërë takim më shumë se dy orë në zyren e Arsimit. Unë e ceka që e kam pasur të pamundur me shkuar në 12 takimet e kët Komiteti sepse në takimin e parë e kemi treguar planin, planifikimin, vizionin tonë për arsim në Komunën e Malishevës. Prof januz i dinë planifikimet të cilat i ka DKA-ja dhe unë kam menduar që i pres rekomandimet dhe bashkarisht ne të bëjmë diqka për to. Nuk do të thotë që ne nuk kemi raporte me komitetin për Arsim përkundrazi unë e ceka që e vlersoj shumë punën e secilit takim, dhe secilën vizit të shkollës që kanë qenë.

Argjend Thaçi: Shkojmë në pauz pastaj vazhdojmë seancën në ora: 13: 30.

Vazhdojmë me seancën, me pikën e radhës e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës së Komitetit për Barazi Gjinore. Urdhëro Valjeta Hoti!

Valjeta Hoti: Përshëndetje për të gjithë!

Besoj që e keni lexuar këtë raport , thjesht po e bëjë një përmbledhje të shkurt se edhe ashtu plani i punës së Komitetit për vitin 2022 ka qenë i punuar në bazë të 3 muajve të fundit.

Konsideroj se ajo qka ka qenë e planifikuar në bazë të planit të punës edhe është realizuar.

Meqenëse ky Komitet bashkëpunon me zyrën për barazi gjinore edhe pjesën më të madhe të aktiviteteve i kemi të përbashkëta andaj realizimin e tyre është bërë nga kjo zyre, ndërsa ne si Komitet e kemi parë të arsyeshme që të realizojmë disa vizita të cilat nuk kanë mundur të realizohen arsyet se përse i gjeni në Raport. Pjesa më e rëndësishme e këtij raporti konsideroj se janë edhe rekomandimet, kërkesat që ne si komitet i kemi pa të arsyeshme dhe besoj se do të kemi edhe përkrahjen tuaj.

Argjend Thaçi: Kalojmë në pikën e 5: Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të varrimit për vitin 2022.Urdhëro, Fadil!

Fadil Shala: Përshëndetje për të gjithë!

Unë jam Fadil Shala, udhëheqës i sektorit të shërbimeve publike. Sa i përket raportit të cilën e keni kërkuar dhe të cilën e kemi obligim ligjor të raportimit rreth shërbimit të varrimit që e kryen kuvendi komunal i Malishevës për të gjithë qytetarët e Malishevës. Ky Raport është i fokusuar kryesisht për vitin 2022, i keni të detajuara të gjitha rastet e vdekjeve. Nëpërputhje me marrveshjen e lidhur nr.01/22 me datë: 22.01.2021, në mes kryetarit Ragip Begaj dhe Bashkësisë Islame z. Sead Paqarizit, nga kjo marrëveshje, përkatësisht nga neni 1,2,3 i kësaj marrëveshje kanë dalur dhe obligimet të cilat ka pasur për detyrë të implementoj operatori në këtë rast Bashkësia Islame, për shërbimet e varrimit. Ju siç e dini kjo marrveshje ka qenë dy vjeqare, ka përfunduar dhe rekomandimi jonë si drejtori kërkojm nga ana juaj dhe nga kryetari i komunës që kjo marrveshje të vazhdohet. Si raste të vdekjes në vitin 2022. Drejtoria për financa ka bërë pagesën në vlerë prej 56.580.00 euro përkatësisht për 246 raste që i referohet muajit janar-tetor, ndërsa muajin nëntor dhe dhjetor janë 58 raste në vlerë financiare 13.314.00 euro bartet për vitin 2023 si obligim që duhet ta kryej drejtoria për ekonomi dhe financa. Faleminderit!

Argjend Thaçi:Urdhëro, Alban!

Alban Kastrati: Fadil, te statistikat që janë nxjerrë thotë një pa pages, zero pa pagesë , prapë vazhdon 3 pa pagesë. Kjo pa pagesë për cilat kategori është.

Fadil Shala: Pa pagesë ka qenë në bazë të marrveshjes, përkatësisht të nenit 3 të marrveshjes që rastet e fëmive prej moshës 0 deri në moshën 5 vjeqare në rast të vdekjes nuk është hyrë ne pages.

Argjend Thaçi: Faleminderit Fadil për paraqitjen e Raportit të shërbimit të varrimit.

Shpeshherë e kemi përmendur që kjo është njëra ndër punët më të mira që e ka bërë Komuna e Malishevës në raport me qytetarët dhe qytetarët janë shumë të kënaqur me këtë shërbim. Ne në senacën e kaluar por dhe në këtë seancë e përsëritëm që përveq që si kuvend ja kemi dhënë lejen kryetarit që të negocjoj me operator të ndryshëm për lidhjen e kontratës dhe besoj që në

momentin që kthehet ligjshmëria prej MAPL-së ai do t'nis procedurat për vazhdimin e kësaj kontrate. Ju si drejtori a keni pasur ndonjë ankesë nga ana e qytetarëve, në lidhje me shërbimet e varrimit. Unë personalisht kam marrur ankesa dhe nga vetë imam nëpër fshatra, të cilët merren me këto qështje në mungesë të materialeve dhe cilësi e dobët kur është fjala te drrasat dhe te arkivoli. Urdhëro, Fadil!

Fadil Shala: Asnjë ankesë me shkrim nuk e kemi në drejtorin tonë rreth këtyre shërbimeve.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Një prej punëve më të mira që është bërë është kjo shërbimet e varrimit që kryhen në nivel të komunës nga qytetarëve. Ne e kemi dhënë dritën e gjelbër kryetarit që të vazhdojë me kontratën e mëtutjeshme me Bahkësinë Islame dhe është një punë që po kryhet shumë mirë. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: Raporti është shumë i qartë dhe nuk ka ndonjë qështje që na jep hapsirë për me ngrit. Qytetarët e komunës së Malishevës jo të gjithë janë të një përkatësie fetare, si trajtohen rastet për të cilat i përkasin fenë islame dhe cili është modaliteti juaj si drejtori keni me t'ia trajtë tani me marrveshjen e re.

Fadil Shala: Dhe marrveshja e bënë një trajtim të till kur kemi raste të besimeve të ndryshme dhe shkohet konform realizimit të ceromonis në të cilën kërkohet.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Amrush!

Amrush Helshani: Faleminderit z.Shala për prezantimin e këtij Raporti të detajuar dhe përmbajtësor. Rastet me covid dhe rastet që vinë nga jashtë shpenzimet janë të njëjta në raport me intereson ta di se a janë trajtuar të gjitha njëjtë si raste të vdekjes. Nëse janë trajtuar njëjtë i rekomandoj dhe drejtorisë dhe zyrës së kryetarit që marrveshjen e re që këto shërbime të parashihen që paguhën vetëm shërbimet që i merr në këtë rast familjari. Sepse nëse vjen nga jashtë vjen me arkivol ndoshta është mirë me u specifiku në marrveshjen e re.

Argjend Thaçi: Urdhëro, nënkryetar!

Vesel Krasniqi: Kjo është është një marrveshje mes komunës dhe Bashkësisë Islame dhe përderisa nuk ka një kërkesë tjetër të mendimit ndryshe, atëherë nuk kemi përgjigje. Kjo marrveshje vjen si kërkesë e Bashkësisë Islame për qështje tjera jo që dojmë me t'ia diskriminu qytetarët, mirëpo janë ceremoni tjera dhe përderisa nuk kemi kërkesë tjetër ne nuk kemi si t'i përgjigjem.

Valon Mazreku: Për ne rëndësi ka që i paguajm shërbimet e varrimit dhe nëse kjo marrveshje ka ardhur si rezultat i kërkesës së Bashkësisë Islame, atëherë kjo vetvetiu pa pasur qëllime e krijon një lloj diskriminimi. Komuna me ligj i paguan shpenzimet e varrimit dhe ritet fetare nga

Bashkësisë Islame sa e di unë nuk paguhen përmes kësaj marrveshje. A keni biseduar besimin tjetër fetar që dhe ata tjerë qytetarë kanë nevojë me u mbështet dhe cila është forma që duhet me u mbështet .

Halil Morina: Valoni e din që dhe në mandatin tjetër ne e kemi diskutuar këtë temë, e dimë që në Komunën tonë shumica e qytetarëve dërrmuese i përkasin besimit në diqka, ceremonit e varrimit përfundohen fetarisht. E dimë që në komunën ton ka qytetarë që janë të kompensioneve të tjera fetare, dhe kjo nuk ngjallë asnjë problematik. Meqë kemi një numër të vogël të qytetarëve që i përkasin konfencioneve të tjera fetare, drejtorja e shërbimeve publike mundet shumë lehtë me gjetë alternativa të tjera se si me ja përfundu shërbimin. Përveq hapjes së varrit që është e njëjta dhe nëse ata e kanë ndonjë specifikacion pak më ndryshe bëhet në mënyr të veçant përmes drejtoris së shërbimeve publike. Kjo marrëveshje që e kemi lidhur ne deri tani nuk shkakton asnjë penges në trajtimin e rasteve tjera.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Fadil!

Fadil Shala: Vetëm desha të i kthej përgjigjie Amrushit, gjatë raportimit tregova se shërbimet nuk janë të specifikuara detalisht po flas për marrveshjen e fundit e cila ka qenë për rast. Qdo familjar i cili ka raportuar rastin e vdekjes, ka pasur raste që kanë kërkuar vetëm hapjen e varrit.

Argjend Thaçi: Kalojmë në pikën e radhës që është: Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Në faktë është plotësim-ndryshimi i kësaj rregullore sepse këtë rregullore e kemi miratuar në fillim të vitit 2022. Urdhëro Blerim!

Blerim Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!

Është kthyer kjo rregullore për tri qështje që të plotësohet dhe të miratohet nga ana e juaj specifikisht njëra qështje është për ambula e cila është kërkuar që të shtohet vendimi nr. 07/2021 mbi pezullimin e shërbimeve komunale për mbledhjen e detyrimeve të pa paguara të tatimit në pronë. Kërkoj falje që në Komitet nuk ka shkuar materiali i kompletuar disa asambleistëve, por besoj që tashmë e keni të kompletuar me 11 faqe. Qështja tjetër e keni lexuar tashmë te neni 5 paragrafi 2, nën paragrafi 2.3 është kërkuar të futet si pikë vërtetimi tatimi në pronë të cilën aplikuesi nuk ka borgje aktuale të pashlyera nga tatimi në pronë. Pra të kërkohet vërtetimi i qdo aplikuesi që nuk ka obligime ndaj Komunës në tatimin në pronë.

Pika e tretë për ndryshim që është kërkuar është kërkuar që të specifikohet dhe shuma e subvencionimit të këtyre ndërmarrjeve, e cila është te neni 13 paragrafi 2 që i kemi parapa për këtë vit të ndahet shuma në vler të 200.000.00E për subvencionimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Për këtë arsye të jetë e implementueshme kjo rregullore kërkoj nga ju që të aprovohen.

Argjend Thaçi: Urdhëro Agnesë Kastrati!

Agnesë Kastrati: Përshëndetje për të gjithë!

Ne si grup i VV-së e kemi lexuar në tërësi rregulloren specifikisht me ndryshimet që janë

propozuar, dhe kërkojmë që në këtë rregullore me u përfshi edhe disa ndryshime të tjera që ne i konsiderojmë të nevojshme prandaj më lejoni që ti theksoj një nga një. Te neni 5 kriteret e përgjithshme dhe dokumentet për aplikim, mirë është që të specifikohet që aplikuesi për grand duhet të jetë banorë i Komunës së Malishevës mendoj që kjo është vetëm një qështje teknike. Neni i 6 kriteret për përzgjedhje është mirë të shtohet që përparësi në përfitim do të jetë si kriter edhe kategoria gjinore, të kenë përparësi gratë.

Neni 9 që është komisioni vlerësues përshembull neni 9 paragrafi 1.1 Anëtarët e komisionit vlerësues është mirë me u specifiku si ekspert ose si përfaqësues të organizatave jo qeveritare, sepse me i vendos vetëm kështu siç është aktualisht mendoj që lenë shumë hapsir për me u keqkuptu.

Është edhe një pikë që thotë anëtar me mandat një vjeqar kjo pjesë është e pakuptueshme, qfarë mandati një vjeqar, do të doja të kem sqarime.

Neni 10 Komisioni për shqyrtim të ankesave, këtu ndoshta është mirë me u rekomandu që në këtë komision me qenë pjesë dhe këshilltar Komunal, sepse kjo do të na ndihmonte që ne si kuvend Komunal të bëjmëdhe monitorimin e ankesave ta përcjellim gjendjen deri te përzgjedhja e përfituesve. Nëse përfshihen këto ndryshime të cilat i ceka ne si grup i VV-së votojmë për. Faleminderit.

Argjend Thaçi: Urdhëro Drejtor!

Blerim Thaçi: Duke u mbështetur në atë që është rregullore Komunale e kemi pasur parasysht dhe komisioni kur ka bërë hartimin e rregullores ku është fjala për qështjen e bizneseve të banorëve të komunës së Malishevës megjithatë është mirë të përmendet dhe ajo pjesë. Ndërsa të përfshira gjinore te prioritetet dhe tipet në përparësi, duhet të jenë një modalitet të mos dalim diskriminuese por është një gjë e mirë që duhet të kërkohet. Te qështja e Komisioneve, komisionet janë të mbështetura me ligj ne nuk mund ti ndryshojmë sa anëtarë, mandatin e tyre dhe as përbërjen. Për këto dy pikat e tjera që i ceke pajtohem.

Argjend Thaçi: Urdhëro Nënkrjetar!

Vesel Krasniqi: E nderuar me të drejt kërkuat kur është qështja te kriteret përse mos të ceken të gjitha ato që nevoiten. Përse është anëtar me mandat një vjeqar, është për arsye se kjo rregullore mund të ndryshohet dhe miratohet qdo vit. Nëse e vëreni aty vlerën monetare ka të bëjë me mandat një vjeqar, ky Komision ka vendos me mjete të cilat janë ndarë për vitin fiskal. Për këtë arsye mandati i anëtarit është një vjeqar.

E cekët te kriteret është mirë me i favorizu gjinit femërore, me të drejt por këtu do të bëhet komisioni i cili do të formohet, sigurisht në mesin e këtyre kriterëve bazike që janë aty ky komision ka me përpunuar një draft të kriterëve që janë varësisht prej veprimtaris të cilën do të aplikon ai biznes do të jenë kriteret të veqanta. Ne kemi menduar ashtu jemi bazu dhe në udhëzime administrative në ligj, në varet sa i caktojnë me pikë por diferencë ka me pasë. Qdo femër e cila ka një biznes dhe aplikon do ta ketë një prioritet me disa pikë dallim.

Argjend Thaçi: Urdhëro Rukije Bytyqi!

Rukije Bytyqi: Përshëndetje për të gjithë!

Dua të lidhem te përfaqësimi gjinor te bizneset dhe subvencionet, unë mendoj që te kriteret të jetë një kriter që nëse përfituesi të jetë femër shuma e subvencionit me qenë 10% më e madhe. Besoj që shumë Gra do të kishin aplikuar për grande.

Argjend Thaçi: Urdhëro Amrush!

Amrush Helshani: Një pyetje për Drejtorin, a përfshihen në këtë rregullore botimi i librave, sepse unë nuk e pashë askund.

Blerim Thaçi: Qështja e subvencionimit të librave janë tri rrugë: subvencionimi nga drejtoria për kulturë dhe nga drejtoria për arsim, mirëpo kemi pasur raste të shpeshta që i ka subvencionu dhe kryetari.

Argjend Thaçi: Faleminderit, e hedhim në votim: Miratimin e rregullores për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme së bashku me propozimet e drejtorit Z.Thaqi dhe propozimet e Agnesës. Kush është për?

Me vota unanime, konsideroj që është miratuar kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i rregullores për orar të punës së subjekteve afariste. Për të prezantuar këtë pikë kemi Drejtorin e Inspektoriatit Z.Hafir Rexha.

Hafir Rexha: Përshëndetje për të gjithë!

Mbështetjet e ligjit të vetë qeverisjes lokale ligji nr. 03/L 040 neni 1-12 paragrafi 2 shkronja C, dhe 40 ligji për tregëtin e mbrendshme me nr. 2004/18 neni 40 ligji për kundërvajtje, dhe ligji me nr. 05/L 087 neni 29 paragrafi 4 dhe 5 të statusit të Komunës së Malishevës. Ju paraqesim para jush një rregullore e cila përcakton orarin e punës së subjekteve afariste në territorin e Komunës së Malishevës.

Në këtë rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës, kujdestarit, pushimi gjatë vikendit dhe festave zyrtare, ditët që nuk punohet për të gjitha veprimtarit afariste tregtare dhe veprimtarit e tjera prodhuese, shërbyese, gastronomi, hoteleri,ndërtimtari, zejtari dhe veprimtarit e tjera të cilat veprojnë në territorin e Komunës së Malishevës. Kjo rregullore posedon 25 nene ku të gjitha e alaburojnë punën e secilit subjekt afarist. Kërkoj nga ju që ta mbështetni këtë rregullore në mënyr që të na lehtësoni punën neve si Inspektoriat. Pres sugjerimet dhe rekomandimet e juaja.

Argjend Thaçi: Urdhëro Valon!

Valon Mazreku: Faleminderit Kryesues! Përshëndetje për të gjithë!

Faleminderit drejtor për prezantimin e kësaj draft-rregullore. Me datën 28.02.2022 po në këtë foltore kam kërkuar që qeveria komunale të bëjë draftimin e një rregullore të tillë, e cila ka për qëllim kryesisht dy elemente.

Elementi parë respektimin e orarit të punës nga bizneset në ditët e pushimit dhe të festave zyrtare. Elementi i dytë për arsye të mos respektimit të ligjit të punës nga ana e bizneseve në raport me puntorët të cilët ata i kanë të punësuar. Ne jemi dëshmitarë që puntorët në disa biznese punojnë mbi 12 orë në ditë, dhe nuk e kanë asnjë ditë të vetme pushim. Kjo ka qenë njëra nga arsyet që më ka nxit me bërë këtë kërkesë, e falenderoj komunën nuk e kanë pasur dhe këta thjesht me ardhë deri te draftimi i një rregullore. Konsideroj që nuk është vonë dhe ne të fillojmë të ju dalim në ndihmë të gjithë puntorëve dhe gjithë atyre të cilët ndihen ose janë të diskriminuar në punën që kanë. Sa i përket rregullores, unë konsideroj që do të duhej të ndryshohen disa pika të cilat i kam evidentuar. Po filloj nga:

Neni 4, pika 4, Sallonet e ondulimit për femra të kenë të drejtë të punojnë edhe të martën. Po ashtu te pika 4.6 kam kërkuar të mos ketë kufizime në orarin e punës.

Neni 5, pika 4, të shtohet një market në Kijevë gjatë vikendit përkatësisht të dielën.

Neni 6, pika 1 dhe 2, orari i punës të jetë prej orës 07:00 deri 19:00 dhe të mos ndahet në verë dhe dimër.

Neni 7, pika 2, të mos ketë kufizime në orar.

Neni 8, në të gjitha pikat e këtij neni të mos ketë kufizime në orar dhe mund të punojnë gjatë të dielave dhe ditëve të festave zyrtare.

Neni 15, pika 2, të ndryshohet dhe të bëhet në këtë mënyrë: Një barnatore është e obliguar të kujdestarojë prej orës 22:00 deri në ora 07:00 në distancë prej 200m nga objekti i QKMF-së.

Neni 19 dhe 20 të largohen komplet nga rregullorja.

Argjend Thaçi: Urdhëro Agnesë!

Agnesë Kastrati: Përshëndetje!

Atëherë me vëmendje e kemi lexuar këtë rregullore, përveq disa përmisimeve teknike i kam tri qështje.

Qështja e parë është: Neni 4.4 dhe neni 4.5 ku rregullohet orari i punës së salloneve të ondulimit për vajza e gra dhe për burra. Do të duhej që të dy këto kategori të punohej dhe gjatë të dielave dhe të jenë ekuivalente jo siq janë ndarë. Mendoj se duhet me u adresu si qështje e njëjtë. Sa i përket neni 9, orari i punës për klube nuk është ekuivalente me orarin e sallave të dasmave, dhe nëse orari i punës për klube është më i gjatë siq është aktualisht në krahasim me sallat e dasmave atëherë bëhet diskriminim dhe do të duhej të trajtoheshin njëjtë këto dy qështje.

Neni 19 është mirë të hiqet komplet ose minimalisht të përfshihet dhe një nen tjetër, ku krahas rritjes të orarit të punës për biznese kjo nuk i ndikon punëtorët sepse ne të gjithë e dimë që me rritjen e orarit të punës të një biznesi kjo në automatizëm ndikon në rritjen e orarit për puntor.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban!

Alban Kastrati: Unë po ndalna te neni 15, orari i punës së barnatoreve ordinancat e klinikave private, është kërkesë e imja në pikën 15.2, një barnatore do të kujdestarojë prej orës 22:00 deri në

ora 07:00. Unë kisha kërkuar që këto mos me kanë vetëm një barnatore por të shtohet dhe një, për arsye se unë personalisht kam pasur disa herë pacienta familjar në ambullant mbas orës 22:00 dhe më është dashur me shku deri në bamatoren tek rrethi me ble një ilaç. Do të ishte më praktike dhe më e lehtë për qytetarët. Në parim e mbështesim si grup.

Argjend Thaçi: Urdhëro Gentianë Hoti!

Gentianë Hoti: E falenderoj drejtorin për prezantimin e kësaj rregullore. Ajo që desha të propozoj është dispozita ndëshkuese neni 21, propozoj që gjoba që është e shenuar 250E të bëhet 500E. Mendoj që kjo gjobë është më e lartë dhe bizneset do ti rekomandohen kësaj rregullore.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Meqë i dhamë rekomandimet e tona përmes anëtarit të grupit tonë, rritja e orarit të punës së biznesit nuk prejudikon rritjen e orarit të punës së puntorëve. Puntori yt paguhet në bazë të ligjit të punës në bazë të kontratës të cilën e ka. Sa i përket barnatoreve unë konsideroj që është e mjaftueshme nëse ne e bëjmë siç ne e propozuam, që barnatoret të jenë në kujdestari në një hapsir prej 200m larg objektit të QKMF-së, atëheer një do të ishte e mjaftueshme. Sa i përket të ngritjes së gjobave dhe unë kisha thënë me rrit qmimin e gjobave, sepse përshebull një market mund të punoj dhe nuk e ka problem me pagu 250E dënim.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih Bibaj!

Nebih Bibaj: Më mirë është që ju si inspektoriat me vu kontrollen në mbikqyrje të bizneset, a janë duke e zbatuar ligjin e punës në përpikmëri në raport me puntorin. Kjo 200m i barnatores, a e kap deri te kryqi apo jo, megjithatë një barnatore duhet të jetë në funksion në kujdestari sepse ka nevojë dhe kjo 200m mos po i hin në hak dikujt tjetër që mundet me pas 201m. Kjo formë nuk po më duket që është forma më e mirë e mundshme.

Argjend Thaçi: Urdhëro Nënkryetari!

Vesil Krasniqi: Unë ndëgjova shumë propozime, nëse hiqet neni 19 duhet të hiqet dhe neni 20, për arsye, sepse e kanë të njëjtin kuptim. Mendoj që disa i përmendi Valoni dhe pajtohem plotësisht te ndryshimi i orareve përderisa bëhen ato ndryshime neni 19 dhe neni 20 nuk kanë kuptim dhe duhet të hiqen pajtohna plotësisht.

Ndërsa te kujdestaria e barnatoreve pikërisht ajo që tha Albani mos me u maltretu që me shku deri te barnatoret te rrethi apo ajo që është për Banjë, atë që e propozoj Halili mendoj që është e qëlluar 200m i përfshin të gjitha ato barnatore që janë aty vetëm këto me kujdestaru. Te gjoba duhet me qenë në konform ligjit ne nuk mundemi me propozu gjoba sa mundet me qenë.

Argjend Thaçi: Urdhëro Drejtor!

Hafir Rexha: Faleminderit shumë për kontributin e dhënë!

Unë u mundova me i shenu propozimet e juaja në bazë të neneve që i kemi paraqitur këtu,

pothuajse ishin nenet apo pikat e njëjta të cilat ju po kërkonin të ndryshohen. Unë dua ta falenderoj Komisionin që ka bërë një punë të jashtëzakonshme me muaj të tërë me ardhë deri te finalizimi i kësaj rregullore. Valoni kërkoj një sërë Nene të ndryshimit dhe po ashtu të hiqet neni 19 dhe 20, dhe neni 19 dhe neni 20 e kanë rolin dhe rëndësin e tyre që e kryejn zbatimin e kësaj Draft-rregullore. Neni 15 me nën nenet e saja i dhuron kompetenc ndryshimit pa qenë në kuvend Kryetari i Komunës me raste të festave të cilat parashihen.

Agnesa, kërkoj te neni 4.4 që ishte për sallone të ondulimeve gjatë jetës së përditshme një takim që e kanë pasur ato vetë me inspektoriatin vetë e kanë caktuar ditën e Martë ta kenë ditë pushimi. Dhe te neni 9 i klubeve që është i përcaktuar, që në fillim i kemi kërkuar rekomandimet e juaja, sepse ju jeni ata që i jepni dritën jeshile kësaj rregullore dhe e bëni të zbatueshme këtë rregullore. Ndërsa te neni 15 që po kërkonin te barnatoret 200m, gjatë përditshmëris që kemi ne si inspektoriat ne kemi probleme me bë orarin për një barnatore me kujdestaru sepse po shkaktohen shumë pabarazi.

E ceki dhe Hamiti që në urgjencë pas orarit aty ka ineksione. Ne e kemi propozuar dhe ju vendosni që këto barnatore te cilat janë në rreth mos të tërhiqen sepse e vështirësojnë punën e inspektoriatit shumë me hartimin e orarit. Ne e bëjmë kordinimin e orarit së bashku me to dhe mos po krijojmë pabarazi.

Te neni 19 për gjoba i përcakton ligji, atë që tha Nebihi janë inspektorët e punës ne vetëm i mbështesim sepse Komuna e Malishevës nuk ka inspektor të këtij lloji, kompetencat janë në Ministri të punës. Ne si inspektoriat i mbështesim të gjitha propozimet e juaja ju jeni ata i vendosni por për me qenë e zbatueshme me lehtësi dhe në dobi të qytetarëve ne kërkojmë që rregullorja të shkoj kështu siq është e propozuar para jush.

Argjend Thaçi: Urdhëro Nënkryetar!

Vesel Krasniqi: Unë mendoj që është në kundërshtim të qdo norme juridike të ketë dy kuptime, apo dy vendimarrje. Kur nxjerret Rregullorja është Rregullore dhe brenda saj ti jepet hapsirë vendimarrje kryetarit kjo nuk është e drejt. Hafir, neni 15 që e përmende, duhet të hiqet patjetër, sepse duhet të jetë vendim i prerë për të gjitha subjektet.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit!

Hamit Lima: Përshëndetje për të gjithë!

Te pika 5 që është 5.4 supermarket vetëm një duhet të punoj ditën e diel dhe këtu sipas meje është pak sepse është një numër i madh i banorëve. Unë kisha propozuar dy supermarkete të punojnë gjatë ditës së diel, një në rrugën për Rahovec dhe një për Arllat, ndërsa të dielën tjetër të jetë një për Kijevë dhe një për Banjë.

Te pika 7 drejtor nuk pash askund për kafiteri, se a kemi të drejt të dielën me punu. Autolarjet a kanë të drejt punë ditën e diel, ose a kemi mundësi me bërë ndonjë kërkesë që ditë pushimi të bëhet ndonjë ditë tjetër e javës sepse të dielën ka punë më shumë?

Këto pompat e benzinave që janë së bashku me kafiteri si trajtohen?

Hafir Rexha: Ato trajtohen veq, marketin e rrokë neni tjetër e pompën tjetër. Ne kemi markete që ka dhe tekstil dhe gjëra ushqimore.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit!

Hamit Lima: Te dita e diele që është vetëm një market të punojë unë mendoj që duhet të jenë dy markete. Një market të jetë për Rahovec e tjetri për Carralluk, ndërsa të dielën tjetër një në rrugën për Banjë dhe tjetra për Kijevë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Gentianë!

Gentianë Hoti: Unë pajtohem që të jenë dy supermarkete të hapura, mirëpo unë propozoj që një të jetë në Malishevë dhe një në Kijevë, sepse ajo zona është më larg dhe e kanë të pamundur që të shkojnë në marketin për Carrallukë ose për Rahovec.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: U tha prej drejtorit që po kemi munges të bëhet kujdestari për shkak të mungesës së farmacis. Ne po dëshirojm me ba, cila është zgjedhja më e lehtë për qytetarët e komunës së Malishevës dhe kjo zgjidhje është që qytetarët ta kenë sa më afër QKMF-së një barnatore. Unë kërkoj që të mbetet kjo të jetë 200m larg QKMF-së barnatore.

Sa i përket nenit 19.5 është I pa arsyeshëm. Janë dy nene që bien ndesh njëra me tjetrën dhe ajo pikë duhet të hiqet nga aty.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Agnesa!

Agnesa Kastrati: Në nenin 8 kur bëhet fjalë për sallat e dasmave ato duhet të punojnë deri në ora 1 pas mesnate, kurse në nenin 9 kur flitet për klubet e natës duhet të punojnë deri në 3. Neni 8.3 sallat e dasmave kur orgaizojnë ahengje të ndryshme orari I punës është për të dy sezonet nga ora 8 deri në ora 1, ndërsa neni 9.2 orari I punës për klubet e natës e të ngjajshme që organizojnë muzik live 7 ditë javë në përiushën verore dhe dimrore nga ora 8 deri në ora 3. Këtyre ose duhet ti bëhet njëjtë, sepse kanë karakter të ngjajshëm, sepse mua këtu po më duket se po diskriminohen sallat e dasmave.Faleminderit!

Hafir Rexha: Kjo Rregullore ka qenë në dëgjim publik dhe ka qenë mirë që të marrin pjesë aty dhe kishim bërë ndryshime.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Unë pajtohem me drejtorin që këto vërejtjet që ne sot po i japim është dashur të jepen me kohë, për këtë ne po kërkojmë që kur të vinë draft-Rregulloret, debatohen në kuvend, del në dëgjim publik dhe pastaj kthehet prapë në kuvend dhe bëhet me plotësim ndryshim dhe të kuvendit dhe të dëgjimit publik dhe atëherë shkon tutje. Nuk kanë shku anjëherë kështu rregulloret dhe nuk duhet të shkohet në këtë formë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: Ne jemi konsultuar me grupin dhe jemi ardhur në përfundim që këto pika duhet të ndryshohen dhe në qoftëse nga shumica konsiderohen që janë të arsyeshme këto ndryshohen.

Argjend Thaçi: Urdhëro, nënkryetar!

Vesel Krasniqi: Nëse shikohen procedurat ligjore, unë mendoj që janë zbatuar gjitha procedurat. Është mbajtur dëgjimi publik dhe secili ka mundur të jep mendimin e vet dhe komisioni e ka kryer punën e vet. Konsideroj se disa kërkesa të asambleistëve janë të arsyeshme, unë propozoj që ato propozime si grupe ti shënoni dhe ti drejtohi kryesuesit dhe në një takim të komisionit që e ka bërë këtë Rregullore t'i merr përsipër brenda suazave ligjore dhe ti ndryshojmë dhe ato ndryshime që bëhen të prezantohen në një seancë tjetër.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi: Më mirë është ta kemi një Rregullore, sesa me kalu të gjitha këto biznese pa kurrfarë Rregullore dhe ka mundësi të përmirësimit. E jona është me ju dalë në ndihmë që këtë Rregullore me ba komuna të paktën një ditë me pas pushim. Nuk mjafton një barnatore ose një market në gjithë territorin e Malishevës. Ka nevojë që Rregullorja të plotësohet.

Vesel Krasniqi: Unë dhe në grup por dhe me kryesuesin bisedova që marketet, supermarketet le të bëhen si në përfundim të dielen spunohet. Nevoja e barnatoreve është diçka tjetër sepse ka të bëjë me shëndetin, mirëpo dhe këtu duhet të specifikohet që një ditë të jetë e lirë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Ne po e shohim që i kemi disa dilema rreth kësaj çështje të marketet, të farmacit dhe ne mundemi me i dhënë hapsirë pak vetit me e analizu pak më shumë dhe me i harmonizu sa më shumë qëndrimet tona.

Argjend Thaçi: Shkojmë në votim për shtyrjen e pikës së Rregullores për orar të punës së së subjekteve afariste. Kush është për që kjo pikë të shtyhet?
Me vota unanime, shtyhet kjo pikë.

Kalojmë në pikën tjetër Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Shërbime Publike. Urdhëro, Fadil!

Fadil Shala: Në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve që i kemi si drejtori dhe rregullimin e ushtrimit të veprimtarisë të kësaj drejtorie, ne para jush kemi paraqitur një draft i cili është hartuar nga ana e komisionit që është hartuar nga kryetari. Ky draft është hartuar si unifikues për të gjitha komunat nga ana e kolegjiut të zyrtarëve ligjor që është në kuadër të Asosacionit të komunave të Kosovës, dhe ne si komision kemi pasur disa plotësime ndryshme të cilat kanë qenë kryesisht për komunën tonë. Fusha në të cilët rregullohet kjo rregullore dhe që i trajton janë të

specifikume, shërbimet për furnizimin me ujë, qështjen me mbeturina, kanalizime, ndriqimit, qështja e trajtimit të deponive të mbeturinave dhe qështjet tjera.

Argjend Thaçi: Nëse nuk ka diskutues e hedhi në votim. Kush është për miratimin e Rregullores për Shërbime publike ?

Për: 15

Kundër: 0

Abstenim: 6

Me 15 vota për, asnjë kundër dhe 6 abstenime, miratohet Rregullorja për Shërbime publike.

Kalojmë në pikën tjetër: Formimi i Komisionit për emërimin e rrugëve. Ky komision është në përbërje prej shtatë anëtarëve, 5 antarë nga kuvendi dhe dy anëtarë nga kryetari. .Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Ne si parti politike e kemi një propozim dhe është Burim Paqarizi.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Agnesa!

Agnesa Kastrati: Në këtë Komision ne e propozojm Valon Krasniqin.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Gentianë Hoti!

Gentianë Hoti: Në këtë Komision propozoj Valon Mazreku.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit!

Hamit Lima: Në këtë Komision, propozoj Driton Kastrati.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Eqrem!

Eqrem Morina: Për këtë Komision propozoj Donjetë Shijaku.

Emrat e propozuar për antarë të Komisionit për emërimin e rrugëve janë Burim Paqarizi, Valon Mazreku, Valon Krasniqi, Driton Kastrati, Donjetë Shijaku dhe dy përfaqësues nga kryetari.

Kush është për këtë përbërje?

Për: 21

Kundër: 0

Abstenim: 2

Me 21 vota për, asnjë kundër dhe 2 abstenime, miratohet përbërja e Komisionit për emërimin e rrugëve.

Urdhëro, nënkryetar!

Vesel Krasniqi: Ky Komision ka për detyrë, që kërkesat që vijnë për emërimin e rrugëve duhet t'i merr ato emërtime që janë në pritje, sepse nuk mundemi ne me fut diqka tjetër, sepse biem në kundërshtim me ligjin.

Argjend Thaçi: Kalojmë në pikën tjetër: Formimi i Komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokale. Ky Komision është në përbërje prej 7 anëtarëve, 4 anëtarë nga Kuvendi, 2 nga zyra e kryetarit dhe një antarë nga shoqëria civile. Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Uroj që ky Komision që po zgjidhet të kryej detyrën mirë, sepse është një detyrë shumë e vështirë. Në mandatin e kaluar e kemi pasur më lehtë, sepse jemi shkuar në çdo fshat e kemi zgjedhur, ndërsa tani është problem sepse ka bashkim të dy ose tre fshatrave. Për anëtarë të këtij Komisioni propozojmë Alban Kastratin.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit!

Hamit Lima: Për këtë Komision ne propozojmë Argjend Thaçi.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Gentianë!

Gentianë Hoti: Për këtë Komision propozojmë Halil Morina.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Agnesa!

Agnesa Kastrati: Për këtë Komision propozojmë Veton Zogaj.

Argjend Thaçi: Shkojmë në votim të kësaj përbërje, 4 anëtarë nga kuvendi, dy antarë nga Kryetari dhe një antarë nga lokaliteti ku zgjidhen Këshillat lokal. Kush është për?

Për: 24

Kundër: 0

Abstenim: 2

Me 24 vota për, asnjë kundër dhe dy abstenime, miratohet përbërja e këtij Komisioni. Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Si është forma e pagesës për këta anëtarë dhe takimet e këtij Komisioni në qfarë ore i keni caktuar të mbahen?

Argjend Thaçi: Ky Komision ulet dhe e diskuton orën e mbajtjes së takimeve.

Nebih Bibaj: Orën mund ta caktoj Komisioni, mirëpo pagesën duhet ta caktoj Kuvendi. Ne në mandatin e kaluar e kemi bërë një zgjidhje të Komisioni që takimet në zyrë 20 euro ndërsa 30 euro në teren. Ne këtu në Kuvend këtij vendimi të formimit të Komisionit të ja bashkangjesim dhe sa do jetë pagesa për këta anëtarë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë!

Unë e pata një diskutim me drejtorin e fianancave dhe ai tha që niveli qendror i ka ndaluar këto kompenzimet e komisioneve. A është e vërtetë kjo?

Argjend Thaçi: Nuk kemi ndonjë informacion. Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku Unë propozoj që mos të ndahen takime në zyre dhe në teren. Në Rregullore janë 22 Lokalitete dhe unë propozoj që 22 pagesa të bëhen për secilin antarë të Komisionit në vlerë prej 100E.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Krasniqi: Unë propozoj që takimet në zyre të këtij Komisioni të paguhet në shumën prej 40 euro, kurse takimet në teren të kompensohen në shumën prej 20E.

Hamit Lima: Unë propozoj 50 euro.

Argjend Thaçi : Po e vendosim propozimin e Valonit, që shuma prej 100 euro t'i ndahet antarëve të Komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokale. Kush është për?

Për: 20

Kundër: 6

Abstenim: 0

Me 20 vota për, 6 kundër dhe asnjë abstenim, miratohet vendim që antarëve të Komisionit të Këshillave Lokal tu paguhet nga 100E.

Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur. Faleminderit për pjesmarrje!

Procesmbajtësja:

Argenitë Krasniqi-Thaçi



Kryesuesi i Kuvendit

